



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

P R O C E S V E R B A L

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS MBAJTUR  
ME DATËN 24.maj 2002

Mbledhja u mbajtë në sallën e Kuvendit dhe me punë filloi në ora 10,00.

Të njejtën e kryesoi Kryetari I Kuvendit Akademik Nexhat Daci .Gjithashtu në mbledhje ishte e pranishme edhe Kryesija e Kuvendit.në përbërje të plotë. Në mbledhje mori pjesë edhe sekretari I Kuvendit z. Frank Buolin.

Për këtë mbledhje u propozuar ky ;

R e n d d I t e ;

- 1.Shqyrtimi dhe aprovimi I procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Shqyrtimi dhe aprovimi I Programit të Qeverisë së Kosovë

Rendi I propozuar I ditës njizerit u aprovuar nga të pranishmit .

U hap shqyrtimi për pikën e pare të rendit të ditës;  
U aprovuar pa vrejte.

U hap shqyrtimi për pikën e dytë të rendit të ditës;  
Kryetari I Kuvendit AKD. Nexhat Daci I shprehu mirëseardhje kryeministrit të Kosovës z.Bajram Regjepit të cilit ia dha fjalën për prezentimin e Programit të Qeverisë .

z. Bajram Regjepi; Falendero kryetarin për fjalën e dhene dhe pastaj elaburoi Programin e Qeverisë, duke th eksuar burimet formale juridike me të cilat mbështet Programi .Pikësepari ky Program mbështet në Rezoluten 1244 të KS, Kornizën kushtetuese ,standartet nderkombëtare dhe në ligjet që do t'ij aprovoj Kuvendi I Kosovës.

Kyeministri I ceku edhe prioritetet e Programit të Qeverisë .Në vazhdim theksoi se Qeveria e Kosovës Programin e saj e ka ndarë në dhjete pika prioritare, të cilat u korosp ondohen ministrive për udhëheqjen dhe zhvillim të qendrushem ekonomik të bazuar në transparencë dhe përgjegjisi .Në të gjitha fushat si në ; arsim, transport , post dhe komun ikacion ,dhe sistemet informative të arrihen standartet evropiane. Të krijohen skema të mbrojtjes sociale , të pensioneve ,njiveli punsimit etj,

Rëndësi e posaqme ti kushtohet integritit të gjitha komuniteteve etnike në shoqrin e Kosovës .Vemendje e veqant ti kushtohet ambijentit planifikimit hapsinor ,banimit ,të përkujdejses institucionale kulturore ,të rinise ,sportit dhe diasporas.Në fundë theksoi Ky program është përkrahur nga SHBA dhe ka zenë një vendë të merituar.

Pas ekspozeut të Kryeministrit për diskutim u paraqit

- z. Behxhet Brajshori – Minister për kulturë, rini e sport i cili në mes tjerash theksoi dhe njëherit kerkoi që të aprovovhet propozimi i tij për Ligjin për trashëgimin kulturore ,ndersa sportit ti kushtohet një përkujdesje më e madhe për krijimin e mundësive për pjesmarrjen në garat ndërkombëtare.
- Akademik S.Hamiti ; Kryetar I Grupit parlamentar të LDK,në vërejtjet e tij Programin e quajti si një lloj ngjarje .Ai tekstin e Programit të Qeverisë e vlersoi me shumë se një kontrat politike se sa një Program që ka vlera e operacionalizimeve dhe punëve .Ai vrëjti se Programi nuk ka referenca se kur apo në çfarë periudhe kohore do të realizohet .Qeverija duhet të punoj me të gjithë resoret ,me të gjitha kapacitetet e veta për ndërtimihn e demokraci së dhe krijimin e kushteve për zgjedhjen e statusit politik të Kosovës.Mandej Qeveria I vendose në fundë Ligjet e Parlamentit. Në vazhdim z.Hamiti theksoi se teksti I Progr mit të Qeverisë nuk ka raporte reale funksionale me organizmat nderkombëtar përveq atij deklarativ.Programi I Qeverisë duhet të këtë shenjen e Kosovës, sepse ne I kemi institucionet ,kemi Qeveri të Kosovës ,kemi Parlamentin, kemi Kryetarin e Kosovës. Ai në vazhdim permendi termin nderkombëtare ,nevoja praktike na ka mesuar gjerë ketu , se egistojn SHBA pa të cilen ne nuk do të shpetonim nga gjenocidi serb dhe gji thashtu pa ndihmen e SHBA nuk do ti kishim keto zhvillime
- z. Fatmir Limaj ; Në emerë të Grupit parlamentar të PDK –së , kritikoi Programin sepse I njejti nuk parshf rregullimin e statusit të ish luftëtarëve të U Ç K-së dhe të invalidve të luftës . Ai potencoj edhe qeshtjen sociale të popullsisë .pastaj rinin sportin etj.
- z. Rada Trajkoviq; Kryetare e Grupit Parlamentar ‘Kethimi ‘,e cila theksoi se ky dokument qe ne sot po e sh qyrtojmë është ne kundërshtim të plotë me vete Rezoluten 1244 të KS, sepse prek integri tetin e Jugosllavis ,nuk pranon kufinj të Jugosllavisë, Marrëveshjen Hekerup –Çoviq. Ky Program ofron ndarje nga Jugosllavia ,Kosovën e paraqet si të pamvarur . Me këtë rrezikohet integrteti I APJ ,Pronave, tempujve etj. Lidhur me këtë ne do te informojm edhe Bahkësinë nderkombëtare .Në vazhdim theksoi Edhe menyren e integritimit në Bashkësin Evropiane dhe këtë perms lidhjes Serbi-Mali i Zi – Kosovë .Ne një Program të till nuk do ta votojmë dhe se nuk do të jemi pjesmarrs fi zik .
- z. Dzezair Murati ;Vatan ; Theksoi se ky Program është hartuer mire dhe në mënyre profesionale ,ka disa dis mangësi qe nuk jane përfshir në te ,si p.sh. bujqsin ,refugjatet ,arsimimin etj.

P a u z a u dha për 15 min.

- Pasë pauzes seancen e udhëhoqi anëtari I kryesies z. Hydajet Hyseni Deputeetet vazhduen me diskutimet e tyre të lajmruara ma pare,
- z.Sanije Alijaj ; deputete e LDK; Ajo diskutimin e vete e perqendroi në arsim ,dhe ti kushtohet ma tëpër femres ,si dhe të ardhurave përsonale që të harmonizohen ,gjithashtu u angazhua edhe për shum segmente të tjera qe duhet të përfshihen ne Program.
- z.Ismaj Kurteshi ; deputet I PDK Ai diskutimin e vete e vuri në spikam të lidhjes dhe bashkëpunimit ndër kombëtar me vendet qe do të jen synimet e Qevëris ,mandej lidhja me mergatren e jashtme . Ai foli edhe për privatizimin ,pensionet,invalidet e luftës etj.
- z. Bogolub Millosheviq deputet ‘Kethimi ‘ në spikam të Programit vrejti se duhet të perfshihet edhe proble met e femijve të vegjel ,mandej respektimin e lirive dhe drejtave të njeriut ,bashkëjetesa integ rimi ,mandej përparsi duhet të jepet rinisë,iu kushtoj edhe qeshtjes se të shpergulurve serb ,dhe përmendi se të cilat kushte Qeveria duhet ti përmbushi në kethimin e tyre.
- z.Muhamet Kelmendi deputet i AAK; Thesoi se në Programi Qeveria nuk ka paraparë ,angazhimin për zgjedhjen e statusit përfundimtar të Kosovës ,edhe pse është kerkes e vete Kornizes Kushtetue se.Ai ceku se ende Qeveria nuke ka ushtru pushtetin ne tere teritorin e Kosovës , dhe se afër 25 përqindë e teritorit kontrollohet nga serbet., ai i kushtoj vemendje qeshtjes punsimit ,familjeve të deshmorve e tjer. .
- z. Naim Maloku deputet I AAK ;Ai theksoi se Programi ka të meta , sepse ky nuk flet për ambientin ,bujqësin energjetiken etj.

- z. Sabit Rrustemi deputet ; LDK Theksoi; Programi nuk perfshin raportet me presidencen .Ai propozoi qe te hyje ne Program edhe demet te cilat i ka shkaktuer Serbia Kosovës dhe ti paguaj Beogradi. ato deme te luftës dhe ato te 10 vjeqarit te fundit.
- z. Sadik Idrizi deputet VATAN.Ai vuri vrejttjet nga minoriteti musliman ,turkë e tjerë ,per hapjen e shkollave te ciklit te lartë ne gjuhen amtare.Ai paraqiti veshtersit me te cilat po ballafaqohen ,si ato te dokumenteve te udhëtimit ,dhe veshtersit ne rrjetin e PTT,si dhe nuk eshte mbuluar kjo trevë me programin e RTK-së
- z.Haki Shatri ; Deputet I-LDK.Kemi disa vrejttje ne këtë Program Ai si vrejttje tha qe eshte dashtë ne hyrje te Programit sqarohen kompetencat qe ka Qeveria ,dhe te cilat I kanë nderkombëtare ai dha edhe vrejttjet ne faqen 4,5-7 dhe 8 te Programit.
- Z, Ramadan Kelmendi.deputet I LDK ; Theksoi ;se ky Program nuk eshte program i pergjithshem,nuk per mban bartësit, pergjegjsit.Ai dha vrejttje ne faqen 3,7,14,17 dhe 26 te Programit.
- z. Besa Gaxheri deputete e LDK;Në diskutimin e vetë u ndal ne çeshtjen e pronsise ,pastaj propozoi te nxjerren Ligje me prioritet sepse ka probleme ,dhe ka probleme ne ujin ,ne bujqësi etj.
- z. Fatmir Rexhepi deputet I LDK.Ai theksoi se çka ka parapare Qeveria ne Program, për demet qe i ka shkaktuer Serbia Kosovës.
- z.Nekibe Kelmendi deputete e LDK; Theksoi se Qeveria ka menduar për te tjerët ndersa për veten jo.Ajo theksoi se ne te nuk eshte parapar Ligji për themelimin e Ministries se drejtësis ,sistem qe nuk eshte i rezervuar ne kompetencat e PSSP.
- Z. Alush Gashi deputet I LDK.E pergezoi Programin e Qeverisë .Ky duhet te perqendrohet ne liritë dhe drejtat e njeriut ,dhe duhet ta perfshij lirin e plotë dhe pergjegjesin.Politika e jashtme duhet te zhillohet nga Kryetari i Kosovës ,dhe se Qeveria e ka pranuer. Ky Program duhet te shqyrtohet edhe ne komisione.
- Smillka Milisavleviq deputete e 'KETHIMI' Ajo terhoqi vemendjen se standarteve nderkombëtare nuk iu eshte kushtu rendësi ne Kosovë,mandej foli për arsimimin e minoriteteve qe nuk eshte perfshir ne Program,mandej foli për reformat etj.
- z. Arsim Bajrami deputet. i PDK Në diskutimin e tij u perqendrua ne projektligjet qe ka parapare ne Program por propozoi qe tju jepet prioritet dhe te marrin pelqimin Ligji Penal,Ligji i Proc, Penale, Ligji mbi sanksionet etj.Nuk eshte mire qe ministrat nga kabinetet te nxjerrin ligje.Por Qeveria duhet te bashkëpunoi me institucionet shkencore , arsimi duhet te këtë program te veqant .
- z.Tom Hajdari deputet I LDK;Ai ne diskutimin e tij pershkruajti vitet 96-2000.dhe ia hodhi poshte pohimet e deputetit kethimi ,dhe pasetai foli per bujqesin ne keto tri vitet e fundit.
- z.Svetomir Samarxhiq. Deputet 'Kethimi' Ai i kushtoi rendsi shëndetsis qe kjo te vehet ne organizim te ri,por te bazuer ne stadartet evropiane.Sepse ka shkatërimë te mëdha te tyre sidomos ku jetojn minoriteti serb,qe ballafaqohen me probleme dhe ne fund lut UNMIKUN,Qeverin qe ti kushtoi rendsi ma te madhe kesaj lemie.
- z.Exhlale Salihu deputete e PDK ;Theksoi se çdo punë nuk eshte e perkryer ,edhe Programi ka mangësi ne fushen e arsimit dhe shkences , dhe pajtohem me diskutimin e z. H.Kuqit ne te nuk po shofe se nuk eshte perfshir emri shkence.,mandej vuri edhe standart estandardet evropiane etj.
- z.Fetije Këpuska; deputete e LDK ;Ajo I kushtoi rëndsi barazisë gjinore qe nuk iu eshte dhene renëdsi ne Program familjeve te deshmorve, mandej foli për sherbimin e mjeksis familjare ,trajtoj edhe çeshtjen e furnizimit me.barna.
- ZNurishahe Hulaj deputete e LDK Theksoi ; Në Program te perfshihet shëndetsia shkencore, mentale kjo Duhet te zëje vënd .
- z.Sala Ahmetaj ; deputete PDK.Ajo diskutimin e perqendroi ne kultur,dhe preku qeshtjen e gjuhes e cila esht bastaruar ,qe po nxjeren dokumente pa kontrolluara dhe nese vazhdohet keshtu do te pësoi debakel nga gjuha angleze .kerkoi qe te nxjeret nji Ligje.
- z.Naim Jerliu ; deputet I LDK; Ai vrejti se ne Program mungon arsyshmeria për bashkëpunimin ,me Organizatat Ndërkombëtare te shëndetsis etj.

Z Nafije Berisha Deputet LDK Ajo paraqiti vrejttjet ne sferen e sociale.

z.Stojanka Petkoviq deputete 'Kethimi' Ai u vuri diskutimin ne punsimin e popollates jo shqiptare Programi të jete real dhe te I përgjigjet gjendjes reale Preku edhe shtreat kategoris se popollates se pa punsuer , foli per pensionet dhe foli se duhet te zgjidhe dhe te kerkohen menyra per ti zgjedh ato .Programi nuk parashef kategorit e femive ,mandej 1/3 e populates serbe eshte shperngulur dhe gjindet jashte Kosoves.

Z.Agim Krasniqi deputet I LDK. Ai diskutimin e perqendroi qe në Program nuk eshte perfshire E stacionet seimologjike qe duhet ti kete Kosova,

z. Gani Prekopuca;deputet I LDK; theksoi se Kosova nuk është Repuplik dhe ase shtet I pranuar , nuk dime prej cilës struktur po fillojme dhe ,nuk dihen bartesit e ekonomise, nuk jepen sqarime për aviacionin,hekurudhat etj. Keto jane te metat e programit por do ta pranojme si te tille ,por të nxjeren ligjet e ardhëshme të Kosovës. Kerkohet vlersimin e demeve te bera nga Serbia ne lo vjetshun e fundit si dhe ato te bera nga Qeveria e Përkohsheme.

z.Rrustem Ibishi deputet ; Vatan ;Ai foli per kethimin e të shpergulve musliman dhe për integrimin në bashkë sin etnike.

z.Bajrush Xhemajli ; deputet ; PDK; Ai theksoi se Programin e pranoi në tërsi .Ai foli për agjencionin e mire simit .

z. Mahir Yagcilar deputet KDTP;theksoi se sot eshte dite soleme se po aprovohet Programi ,dhe bashkësia turke do të integrohet ,por do te perfshir edhe qeshtjen e arsimit qe kjo nuk eshte kenaqshme .

z. Flora Brovina deputete e PDK; Ajo theksoi se do ta voti Programin ,dhe u perqendruer ne qeshtjen e mbrojt jes sociale dhe foli per rinin,punsimin , migrimin ,pengjet e luftes .

Qeveria duhet ti marri dhe ti shqyrtoi marveshtjet te cilat jane nenshkruar me Serbin .

Kryesuesi jep pushim prej 15. minatash

#### PERGJEGJA E KRYEMINISTRIT NE VREJTAT E DHENA NGA DEPUTET NE PROGRAMIN E QEVERIS.

KRYEMINISTRI Rexhepi ,falenderoi deputetet për vrejttet ,sugjerimet dhe tha se ky Program nuk është i përkryer ka mangësi .

Unë do të përgjigjem për disa pyetje ,por për disa do të japi përgjigjem me shkrim,

Sa I për këte vrejttjeve gjuhësore janë me vendë,eshtë version nuk është korigjuer ,dhe korigjimet gjuhësore do behen

Qdo minister do të debatoi në bazë specifike të veta.

Deklerates se z. Trajkoviq.Unë kete e kambazuer ne Rezoluten l244 dhe Kornizes Kushtetuese.

Sa I për këte laramanise se pagave ,kete e kemi ttrashiguar,por në të do të harmonizohen dhe do te reduktohen ,dhe te gjithë do ta ndajn fatin e njejtë.

Sa I për këtë pensioneve pensinale bazike ,kemi menduer edhe për kete ,por kufizimet e buxhetit nuk lejojn qe tani te kemi shkuer ne caktimin e tyre prej 20 euro gjere ne 28 e.

Qeshtja e privatizimit është pjesë e rezervuar për PSSP .,dhe ne i kemi derguer vrejttet sugjerimet edhe Kryetarit të Parlamentit,por kete smund ta ndryshojm.

Qeshtja e shkollimit te minoriteteve ,ne do te krijojm mundesi qe ta kene shkolimin e larte.

Shendetsia e ndan fatin e te gjithve Ne do te orjetohe mi në ate primare ,dhe sparaqiten specifika .

Ne disa pytte qe jane shtruer do te përgjigjem ne form te shkruar

Hydajet Hyseni ; Kryesues theksoi po e shqyrtojm dhe votojm programin e pare te Qeverisë .

Kuvendi ka kvorum dhe dua te mbshtes ne rreg. Nr.24.pika 3 e Regullores se punës ku u vu ne votim vetem 12 vota ishin kunder

Seanca plenare punimet i perfundoi ne ora 17.20 minuta me 24.05.200

SHERBIMI JURIDIK